



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Specialist në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Aerodromeve.

1. Çfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës, bazuar në profesionalizëm dhe meritë.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në administratën publike ose/dhe sektorin privat.

2. Detyrat e pozicionit të punës

- a) Rishikon të gjithë manualët, procedurat e shkruara dhe manualët e nxjerra nga Sektori i Infrastrukturës në lidhje me planifikimin e aerodromit, projektimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe objekteve përkatëse dhe i përditëson ato kur kërkohet.
- b) Ndhmon Drejtorinë e Aerodromeve(DAD) në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për Regjistrimin/Certifikimin/ regjistrimin e Operatorëve të Aerodromit në Shqipëri në përputhje me rregulloret në fuqi Standardet, procedurat e shkruara dhe direktivat e tjera përkatëse të nxjerra nga AAC.
- c) Ndhmon Drejtorinë e Aerodromeve (DAD) me veprimet e nevojshme për të lëshuar, rinovuar, ndryshuar, pezulluar ose anuluar Certifikatat/Regjistrimet e Operatorit të Aerodromit sipas rastit.
- d) Inspekton ndriçimin aeronautik tokësor (AGL) dhe sigurohet që Operatorët e Aerodromit në Shqipëri të mbajnë AGL në përputhje me kërkesat e zbatueshme.
- e) Inspekton praninë e pengesave në sipërfaqet e kufizimit të pengesave (OLS) dhe shënimin dhe ndriçimin OLS.
- f) Inspekton/Auditon projektimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektrik.
- g) Nëse ndërtimi është në vazhdim, kontrollon shënjimin dhe ndriçimin e duhur të zonës së ndërtimit, shënimin e pragjeve të përkohshme të pistës dhe pajisjet e ndërtimit në zonën e lëvizjes.
- h) Inspekton/ kontrollon dimensionet dhe kushtet e sipërfaqes dhe fortësinë e pistave, rrugëve lidhëse, zonave të ndalimit , zonave të sigurisë në fund të pistës, rripave të pistës dhe rrugës lidhëse, shpatullave dhe apronit.
- i) Mban lidhje të ngushtë me OKKIA për të marrë të dhëna për aksidentet dhe incidentet e avionëve në ose afërsi të aerodromeve për t'u përdorur nga stafi i DAD në punën e tyre të vazhdueshme.
- j) Inspekton/Auditon pajisjet e mirëmbajtjes së aerodromit.

3. Kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës që duhet të plotësojë kandidati

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe dhe angleze, të shkruar dhe të folur
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- e) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna nga institucionet publike apo private, ku ka ushtruar profesionin, e cila nuk është shuar sipas legjislacionit përkatës.

Kërkesat e pozicionit të punës

- a) **Arsimimi:** Të jetë i diplomuar si Inxhinier Elektrik. Niveli minimal diplomës Bachelor.
- b) **Eksperiencia në punë:** Të ketë të paktën 7 vite përvojë pune në profesion (në fushën në të cilën është diplomuar).
- c) **Gjuhë e huaj:** Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente).

4. Dokumentacioni për dorëzim

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- b) Formën e aplikimit të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- c) Fotokopje të diplomës Bachelor.
- d) Fotokopje e librezës së punës.
- e) Vërtetim i gjendjes shëndetësore.
- f) Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- g) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

5. Aftësi të kërkuara

- a. **Ekspertize teknike:** Aplikon njohuritë teknike për të kryer aktivitetet mbikqyrëse në fushën e tij/saj të ekspertizës.
- b. **Inisiativë:** Identifikon dhe adreson çështjet në mënyrë të pavarur, proactive dhe të vazhdueshme për të arritur objektivat.
- c. **Zgjidhjen e problemeve:** Zgjidh problematikat me nivele të ndryshme kompleksiteti dhe rreziku. Merr vendime në kohën e duhur duke konsideruar detyrat, faktet, objektivat, rreziqet dhe konfliktet.
- d. **Të menduarit në nivel sistemi:** Kupton dhe përcakton se si component të ndryshme ndërveprojnë dhe afektojnë systemin e performancës së rreziqeve në operim (safety).
- e. **Udhëheqja dhe puna në grup:** Bashkëpunon në të gjitha nivelet e organizatës brenda dhe jashtë drejtorisë/vektorit për të promovuar vizionin dhe objektivat. Bën të mundur që stafi në varësi të tij të arrijë këto objektiva.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

- Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**;
- Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**.

Kandidati me rezultatet më të larta (por jo më pak se 70 pikë) shpallet fitues, ndërsa kandidatët që marrin të paktën 70 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen në listë pritje.



REZULTATET E VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT

Rezultate e vleresimit të dokumentacionit.

Në datën **13/06/2023**, Autoriteti i Aviacionit Civil do të shpall një faqen e tij zyrtare të internetit, listën e kandidatëve të kualifikuar për intervistë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe vendin dhe datën e zhvillimit të intervistës.

Kandidatët të cilët nuk janë kualifikuar për intervistë mund të kërkojnë informacion me e-mail në adresën zyrtare rekrutime@caa.gov.al , për aryet e moskualifikimit.

Shpallja e rezultatve të konkurimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë), Autoriteti i Aviacionit Civil, do të njoftojë individualisht me e-mail çdo kandidat për rezultatin e pikëve.

Kandidatët të cilët nuk janë dakort me rezultatin, kanë të drejtë të paraqesin ankim me e-mail pranë Autoritetit në adresën zyrtare rekrutime@caa.gov.al . Afati i ankimit është **5 ditë** kalendarike nga data e njoftimit individual.

Autoriteti pas përfundimit të afatit të ankimit do të shpallë fituesin në faqen e tij të internetit.

APLIKIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni dhe të dorëzoni dokumentat e kërkuara (të skanuara) në adresën zyrtare rekrutime@caa.gov.al .

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë në shqyrtim dhe do të njoftojë për intervistë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kanë dorëzuar brenda afatit të caktuar për aplikim dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 11/06/2023.